

AKT EKSPERTIMI
PER ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTAR
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ ERALNI”

Une Donika Abedini , me cilesine e Ekspertes Kontabile te Autorizuar jam e ngarkuar me vendimin e Ortakut te vetem dhe Administrator i shoqerise tregetare “ ERALNI” sh.p.k.“ Tirane , per te kryer ekspertimin per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise.

Per kete qëllim une kam respektuar kerkesat e ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite tregetare”,te ligjit Nr 7661date 19 Janar 1993 “Per kontabilitetin “, si dhe dispozitat e statutit te shoqerise.

Per realizimin e detyres se ngarkuar une kam kryer te gjitha ekzaminimet ne perputhje me Standartet e njohura e te pranuar te Auditimit. Gjate punes time ne cilesin e Ekspertes Kontabile te Autorizuar kam kryer shqyrtimet dhe ekzaminimet e nevojeshme per te arritur ne sigurine mbi gjendjen ekonomiko-financiare te shoqerise dhe per te percaktuar shkaqet dhe mundesite reale qe ekzistojne per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise .

Ne perfundim te krejt puneve te kryera nga ana ime arrita ne konkluzionet si vijon:

Shoqeria “ ERALNI “ SH.P.K.. eshte regjistruar si person juridik me vendimin Nr. 2882 date 21.03.1994 te Gjykates se Rrethit Tirane . Shoqeria eshte me pergjegjesi te kufizuar. Kapitali themeltar eshte 100 000 leke i cili i gjithi i takon Ortakut te vetem dhe Administrator i shoqerise Z.LILI LIKO.

Objekti i veprimtarise eshte percaktuar ne statutin e shoqerise dhe ne vendimin e gjykates per themelimin e kesaj shoqerie.

Ortaku i Vetem me vendimin e tij ka vendosur te zmadhoje kapitalin themeltar nga 100 000 leke ne 17 280 000 leke me nje shtese prej 17 180 000 leke.



Rritja e kapitalit do te behet nga :

1. Fitimi i vitit 2002 e perpara	4 957 467 leke
2. Fitimi I vitit 2003	6 311 500 leke
3. Fitimi I vitit 2004	5 911 033 leke
Shuma gjithsej	17 180 000 leke

Nga fitimi vitit 2004 do te mbetet pa perdorur shuma 2661 leke e cila u be per efekte te rumbullakimit te shumes se kapitalit.

Per te gjykuar mbi kushtet qe do te merren parasysh per zmadhimin e kapitalit, une ne cilesine e Ekspertes Kontabel te Autorizuar jam bazuar ne **bilancin e shoqerise te dates 31 Dhjetor 2004 dhe ne dokumentacionin faktik** qe disponon shoqeria per treguesit qe jane paraqitur ne deklarimet financiare .

Gjate kontrollit te dokumentacionit te kryer nga ana ime rezultoi se Bilanci i shoqerise tregtare " ERALNI " SH P K Tirane dhe dokumentacioni qe pasqyron kalimin e ketyre shumave eshte i sakte, eshte kontabilizuar sipas te gjitha rregullave ligjore dhe pasqyron fare qarte realitetin ekonomik e financiar.

Per sa parashtrova me lart jap miratimin tim ne cilesine e Ekspertes Kontabile te Autorizuar per zmadhimin e vleres se kapitalit themeltar nga 100 000 leke ne 17 280 000 leke.

Akti i ekspertimit si me lart i paraqitet per miratim Z. LILI LIKO me cilesine e Ortakut te vetem dhe Administator i shoqerise tregtare " ERALNI " SH.P.K.Tirane

Tirane , 16.12. 2005

Eksperte Kontabel e Autorizuar
Dr. Donika Abedini

